www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 87

Tiranë – E mërkurë, 25 maj 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 26, datë 20.5.2016	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2016, nga granti "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.....	5009
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 27, datë 20.5.2016	Për shpalljen e thirrjes së dytë, për vitin 2016, për financimin e projekteve, nga granti i arsimit, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.....	5010
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 28, datë 20.5.2016	Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit "Infrastruktura vendore dhe rajonale", Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I.....	5014

VENDIM
Nr. 26, datë 20.5.2016

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA E PARË PËR VITIN 2016, NGA GRANTI "SHQIPËRIA DIXHITALE", PROGRAMI "SHQIPËRIA DIXHITALE", SHTYLLA III, E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2016, për drejtimet sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1.2, të vendimit nr. 12, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nga granti 1: "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik të projektit dhe të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Pas shpërndarjes së financimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, vlera e alokuar për thirrjen I, shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1.2, të vendimit nr. 12, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, e mbetur pa u shpërndarë për financimin e projekteve, prej 130 260 000 (njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, të rialokohet, si më poshtë vijon:

- Vlera prej 70 260 000 (shtatëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, i shtohet portofolit të grantit "Infrastruktura vendore dhe rajonale", Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond të shpërndahet për financimin e projekteve të reja, të thirrjes së rradhës, për vitin 2016, dhe/ose të projekteve në vazhdim, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
- Vlera prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, të financojë thirrjen e dytë për financim, nga granti 1: "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, që do të shpallet në fillim të muajit qershor 2016.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e parë për vitin 2016, përmes granti 1: "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Durrës	Sistemi gjeoportal lokal, Web GIS, për Bashkinë Durrës	15,000,000	10,500,000	4,500,000
2	Bashkia Korçë	Platforma Web GIS për Bashkinë Korçë (teknika të avancuara replikimi)	13,200,000	9,240,000	3,960,000
			28,200,000	**19,740,000**	**8,460,000**

Shënim:

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përllogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016 dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit "Shqipëria dixhitale", Programi "Shqipëria dixhitale", shtylla III e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose projekteve në vazhdim. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).

2. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.

3. "Vlera e financimit", për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2016.

4. Autoritetet kontraktuese të projekteve fituese, përpara nisjes së procedurave të prokurimit, duhet të marrin paraprakisht miratimin e termave të referencës së projekteve që do të zbatojnë, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Kjo kërkesë është paraqitur nga sekretariati teknik (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).

VENDIM
Nr. 27, datë 20.5.2016

PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË DYTË, PËR VITIN 2016, PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE, NGA GRANTI I ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë, për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1. Granti 2: "Arsimi", programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I.

1.2. Drejtimet e thirrjes për financim, janë për:

a) shtim të kapaciteteve pritëse arsimore në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm, për të siguruar përballimin e kërkesës dhe për të mundësuar funksionimin brenda standardeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kryesisht në zonat e mëdha urbane;

b) rehabilitim të objekteve arsimore ekzistuese, të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm, të cilat janë në rrezik shembjeje apo kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe rijetëzimi i terreneve sportive të shkollave;

c) mbështetje për arsimin e lartë dhe atë pasuniversitar, ngritja dhe fuqizimi i qendrave të dijes, forcimi i kapaciteteve arsimore.

2. Për drejtimet sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 1.2, të këtij vendimi, vlera e financimit të projekteve të reja, për vitin 2016, është 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

3. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, dhe institucionet përkatëse për projekte të arsimit të lartë, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara, kryhet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas kritereve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Arsimit dhe Sporteve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

SHTOJCË I
KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
6 qershor 2016 (afat për projektet e pikës 1.2/a, b dhe c)	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi *on-line* në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203. ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 2: " Arsimi", sekretariati teknik pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, **nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por vetëm pranë sekretariatit teknik**.
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
3 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatin teknik organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

SHTOJCË II
FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e Financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016") dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016") dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016") dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Data e fillimit të projektit (*)	

Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërhyrjeve të reja në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Rrisqet për zbatimin e tij; Informacion në lidhje me pronësinë e tokës (në qoftë se parashikohet ndërtimi i një objekti të ri) dhe lirimi i sheshit të ndërtimit, nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), si dhe deklarimin mbi zgjidhjet për mbulimin e kostos së shpronësimit (në formular).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifikë të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon dhe deklaron (në formular) se mbulon: - Koston për mirëmbajtjen e objektit, dhe në rast objektesh të reja edhe koston e pajisjeve dhe shpenzimet operative, pas zbatimit të tij.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, vlera që kërkohet për financim është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga organizata të tjera zhvillimi.
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e bashkëfinancimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (opsionale)	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: i) projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve; ii) projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit, dhe/ose të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejimet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi; iii) janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike etj. (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - argumentimin teknik (relacioni).
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin JPEG ose PDF.
Pamje 3 dimensionale (*) i detyrueshëm përveç programit "Shqipëria dixhitale"	Imazhe në formatin JPEG ose PDF.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:
1.Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:
a) Aplikimi *online* në faqen elektronike të *e-Albania*. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR-në (https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203.)
ose
b) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

SHTOJCA III
KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE
(Shtylla 1 e financimit: zhvillimi vendor dhe rajonal)

A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet

Këto kritere përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 90 pikë**. Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016". Këto kritere konsistojnë në vlerësimin e domosdoshëm për të propozuar një projekt për financim.

Kriteret për vlerësimin e projekteve për financim janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike e aplikimit dhe e kostimit, vlerësimi financiar (oportuniteti i financimit) i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.**

2. Përputhja me politikën, drejtimet e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.**

3. Ndikimi i projektit në shërbimin arsimor të ofruar, në shtimin e kapaciteteve dhe nevojën e ngutshme, në cilësinë e strukturave pritëse arsimore, në përmirësimin e perspektivës për arsimin dhe përdorimin e zhvillimin e aftësive, numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.**

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**

5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, dhe në rast objektesh të reja edhe kostoja e pajisjeve dhe shpenzimet operative, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**

6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**

B. Kriteret e vlerësimit të impaktit

Sekretariati i Përgjithshëm kryen vlerësimin e impaktit të përgjithshëm të projektit, **me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**

Shënim. Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor dhe financiar i projekteve, në zbatim të ligjit për buxhetin dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas kritereve të përcaktuara këtë shtojcë.

2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.

3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatin teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.

VENDIM
Nr. 28, datë 20.5.2016

PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË VAZHDIM TË GRANTIT "INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE", PROGRAMI I ZHVILLIMIT VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2014–2015, për grantin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e vazhdimit të financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015–2016, për grantin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2014–2015, granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vendimi(et) i/e KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në lekë) /veprim korrektues (*)
	QARKU FIER								
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Çermë Sektor, Tre urat-Staravec-Gërmenj i Madh, Tre Urat-Autostradë Rrogozhin-Lushnje L=16Km (Unaza Divjakë)	Nr. 16, datë 10.10.2014	425,016,000	245,507,020	127,504,000	116,354,216	-	1,648,804
	QARKU TIRANË								
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Porcelan - Kinostudio - Surrel	Nr. 14, datë 23.9.2014	417,207,528	264,041,996	54,106,626	162,770,374	-	47,164,996
3	Komuna Farke	Sistemim dhe asfaltim i rrugëve përreth liqenit Farke, shëtitore, ndërtim KUB, KUZ, aksi 1, aksi 2	Nr. 2, datë 9.4.2014	39,576,000	36,023,552	35,071,517	1,852,035	-	-900,000*
	QARKU VLORË								
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Lidhja e rrugës TransBallkanike me superstradën Fier-Vlorë	Nr. 16, datë 10.10.2014	641,123,002	349,178,357	192,336,900	154,012,361	-	2,829,096
	QARKU KORÇË								
5	Bashkia Korçë	Sheshi dhe rrugicat tek kulla panorama, sheshi tek teatri	Nr. 2, datë 9.4.2014	241,914,630	241,191,892	229,000,000	12,191,892	-722,738	-
6	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i parkut Rinia	Nr. 2, datë 9.4.2014	304,502,223	303,596,161	258,000,000	45,596,161	-906,062	-
	TOTALI			**2,069,339,383**	**1,439,538,978**	**896,019,043**	**492,777,039**	**-1,628,800**	**51,642,896**

Shënim

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e investimit dhe vlera e supervizimit dhe kolaudimit.

2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe shumatorja e saj me vlerën e supervizimit dhe kolaudimit "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e alokuar për vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, për të përmbyllur financimin e vlerës së kontratës, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. "Vlera e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e alokuar për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për projektin me nr. 5 dhe 6, të tabelës nr. 1 të këtij vendimi. Për këto projekte shfuqizohet vlera e financimit, me minus, për vitin 2016, dhënë sipas vendimit nr. 9, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016, për këto projekte është në vlerën 0 lekë. Gabimi në përllogaritjen e financimit për vitin 2016, në vendimin e sipërpërmendur është bërë nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), i cili me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016, propozon korrektimin e kësaj vlere financimi.

6. "Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016", tregon diferencën midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës dhe atë të financimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhënë deri tani, që përbën vlerën e supervizimit dhe kolaudimit, e miratuar për projektet me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

7. "Veprimi korrektues për vitin 2016" është vlera me minus që zvogëlon vlerën e financimit për vitin 2016, kur financimi i vlerës së projektit dhe/ose i vitit 2016, mbas nxjerrjes së vlerës së kontratës (nënshkrimit), duhet zbritur respektivisht. Financimi i papërdorur është thithur në zarfin e grantit përkatës.. Propozimi ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

8. Për projektin nr. 3 të kësaj liste, me emërtim "Sistemim dhe asfaltim i rrugëve përreth liqenit Farkë, shëtitore, ndërtim KUB, KUZ, aksi 1, aksi 2", referuar ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative territorial të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Komuna Farkë konsiderohet ish-autoriteti kontraktues dhe Bashkia Tiranë është autoriteti kontraktues.

Tabela 2. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015–2016, granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vendimi(et) i/e KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në lekë)
	QARKU DIBËR							
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i Urës së Lushës mbi lumin Drin i Zi, Komuna Arras	Nr. 17, date 16.3.2015	75,330,337	72,955,154	52,731,236	18,918,556	1,305,362
	QARKU ELBASAN							
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Librazhd-Orenjë	Nr. 22, datë 8.5.2015	30,450,000	28,256,975	21,315,000	6,654,585	287,390
	QARKU FIER							
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës "Kthesa e Bishanit - Bocove - Varrezat e fshatit Bashkim"	Nr. 22, datë 8.5.2015	88,531,238	59,143,978	61,971,867	-3,354,747	526,858
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Kamcisht-Ngurrëz e Vogël, Komuna Krutje, Fier	Nr. 27, datë 29.5.2015	42,499,964	27,774,050	29,749,975	-2,247,725	271,800
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i Rrugës Adë (Karburanti)-Frakull e Vogël, Komuna Frakull	Nr. 10, datë 25.2.2015	82,273,041	44,797,524	57,591,129	-13,151,333	357,728
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Levan-Shtyllas, Komuna Levan	Nr. 10, datë 25.2.2015	126,730,510	84,873,826	69,844,804	14,468,684	560,338
7	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim i rrugës Tozhgez-Zhelizhan-Mazhaj, Komuna Allkaj	Nr. 10, datë 25.2.2015	98,928,509	58,538,542	66,185,397	-8,082,609	435,754
	QARKU GJIROKASTËR							
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i rrugëve në qendër të fshatit Jorgucat	Nr. 17, datë 16.3.2015	58,037,138	39,134,035	40,178,205	-1,418,517	374,347
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Peshtan, Komuna Qendër Tepelenë	Nr. 10, datë 25.2.2015	25,254,944	16,022,058	17,678,461	-1,818,121	161,718
10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rruga e fshatit Goranxi, Komuna Dropull i Sipërm	Nr. 10, datë 25.2.2015	57,288,131	38,407,308	40,101,692	-2,013,092	318,708
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim dhe sistemim i sheshit në qendër të fshatit "Asim Zeneli", qendër e Komunës Antigone	Nr. 22, datë 8.5.2015	28,415,479	18,784,498	19,890,835	-1,332,407	226,070

	QARKU KORÇË							
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i sheshi qendror të fshatit Pustec, Komuna Pustec	Nr. 17, datë 16.3.2015	34,981,682	24,778,151	24,441,529	271,410	65,212
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemimi anësor i Përroit të Madh Qendër Fshati Voskop	Nr. 17, datë 16.3.2015	46,550,605	30,856,168	31,762,149	-1,425,671	519,690
	QARKU LEZHË							
14	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Grykë Manati - Kolsh L=1947 ml dhe ndërtim i rrugës së Varrezave L=530 ml, komuna Kolsh, Lezhë	Nr. 27, datë 29.5.2015	69,502,124	38,400,312	48,651,487	-12,368,107	2,116,932
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim, asfaltim i rrugës Sanxhak, Superstradë	Nr. 22, datë 8.5.2015	101,142,279	94,578,667	70,799,595	23,077,887	701,185
	QARKU SHKODËR							
16	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rivitalizimi i ndërtesave dhe shëtitorja e lumit në Tamarë	Nr. 10, datë 25.2.2015+ Nr. 43, datë 27.11.2015	63,015,374	56,361,740	44,110,762	12,153,178	97,800
	QARKU TIRANË							
17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shëtitores, KUZ, te liqeni i Farkës, Komuna Farkë	Nr. 10, datë 25.2.2015	90,765,048	70,720,365	63,535,534	6,605,475	579,356
18	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i kryqëzimit të Shkozës, Bashkia Tiranë	Nr. 10, datë 25.2.2015	27,324,616	18,574,128	19,127,230	-767,146	214,044
	QARKU VLORË							
19	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i shëtitores së Himarës	Nr. 32, date 15.7.2015	264,782,826	234,314,128	105,913,130	126,969,448	1,431,550
20	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërhyrje për mbrojtjen detare të plazhit, të formuar nga projekti i Lungomares	Nr. 32, datë 15.7.2015	35,985,600	35,443,072	14,394,240	20,928,952	119,880
			TOTALI	**1,447,789,445**	**1,092,714,679**	**899,974,257**	**182,068,700**	**10,671,722**

Shënim

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e investimit dhe vlera e supervizimit dhe e kolaudimit.

2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe shumatorja e saj me vlerën e supervizimit dhe kolaudimit "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e alokuar për vitin 2016, për të përmbyllur financimin e vlerës së kontratës, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. "Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016", tregon diferencën midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës dhe atë të financimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhënë deri tani, që përbën vlerën e supervizimit dhe kolaudimit, e miratuar për projektet me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Propozimi për financimin e kësaj vlere përcillet nga Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë